



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

Nr.22/2010

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-122 për Përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2005/52 mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe

Duke u mbështetur në Planin Strategjik për Sistemin Gjyqësor të Kosovës për periudhën 2007-2012, Këshillit Gjyqësor i Kosovës mori këtë

## V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra (më tutje: Strategjia).
2. Kjo Strategji duhet të zbatohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Njësia e Auditimit Gjyqësor dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të gjitha gjykatat e rregullta dhe ato për kundërvajtje.
3. Caktohet z. Hydajet Hyseni, Koordinator i Njesisë së Auditimit Gjyqësor, pranë Këshillit Gjyqësor, si Koordinator për Zbatimin e Strategjisë (më tutje: Koordinator) dhe i cili duhet t'i raportojë Këshillit Gjyqësor çdo tre muaj rreth përmbushjes së objektivave të Strategjisë.
4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të i vë në dispozicion të publikut raportet tre-mujore mbi progresin e zbatimit të Strategjisë.
5. Ngarkohen udhëheqësit e institucioneve apo bartësit e aktiviteteve të dala nga Strategjia me realizimin e këtyre aktiviteteve në afatet e parapara kohore në bazë të Strategjisë si dhe caktimin e një personi kontaktues i cili do të i raportonte çdo muaj Koordinatorit, të cekur në pikën tre (3) të këtij Vendimi, jo më vonë se me datën pesë (5) të secilit muaj. Emrat e personave kontaktues duhet të i përcjellën Koordinatorit jo më larg se katërmëdhjetë (14) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
6. Ngarkohet Departamenti Ligjor që të përpilojë shkresat, jo më larg se shtatë (7) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, përmes së cilave do të njoftohen të gjithë udhëheqësit e institucioneve apo bartësit e aktiviteteve mbi detyrat me të cilat janë ngarkuar dhe raportimi tek Koordinatori.

7. Ngarkohet Njësia e Auditimit Gjyqësor për të monitoruar zbatimin e Strategjisë në gjykata/njësi tjera siç janë të identifikuara në Strategji.
8. Dështimi në realizimin e aktivitetet të dala nga Strategji apo mos raportimi tek Koordinatori, siç është përcaktuar më pikën tre (3) të këtij Vendimi, përbën bazë për iniciimin e procedurave disiplinore.
9. Kjo Strategji do t'i vihet në dispozicion publikut.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Gjykatat në Kosovë janë të ballafaquara me numër të madh të lëndëve të vjetra të grumbulluara civile, penale dhe të ekzekutimit. Shënimet aktuale statistikore tregojnë se inventari në sistemin gjyqësor të Kosovës vazhdon të zgjerohet, me më shumë se 200.000 lënde në pritje, pjesën dërmuese të të cilave e paraqesin lëndët të vjetra të grumbulluara.

Për më tepër, Këshilli e konsideron të rëndësishme në këtë kohë marrjen e masave adekuate për të dinamizuar procesin e zgjidhjes së këtyre lëndëve, sepse një ndër arsytet që mediat më së shpeshti kritikojnë sistemin gjyqësor janë pikërisht grumbullimi tej mase i lëndëve të vjetra.

Në të njëjtën kohë, reduktimi i numrit të lëndëve të vjetra të grumbulluara është shënuar si prioritet i domosdoshëm në Raportin e Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian.

Andaj, duke marrë për bazë këta faktorë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë,  
18 nëntor 2010

Enver Peci  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit të SKGJK-së
- Gjykatës Supreme,
- Gjykatave të Qarkut dhe Komunale,
- Gjykatës Ekonomike

## PROPOZIM STRATEGJIA SHETETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA 8 NËNTOR 2010

Ky dokument paraqet kornizën e veprimeve të përpiluara nga anëtarët e Grupit punues për zvogëlimin e lëndëve të vjetra të grumbulluara i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të shqyrtojë lëndët e grumbulluar të vjetra në lëmin penal, civil dhe ekzekutive si dhe të krijojë mekanizma përmes së cilëve Këshilli Gjyqësor mund të kërkojë llogaridhënie nga kryetarët e gjykatave. Korniza është miratuar nga Grupi punues me datën 8 nëntor 2010 dhe i dërgohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës për miratim si **Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Lëndëve të Vjetra të Grumbulluara**.

Më parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka miratuar një plan veprimi (Iniciativë për Zvogëlimin e Lëndëve të Grumbulluara) për zvogëlimin e lëndëve civile përmbartimore, bazuar në rekomandimet e projektit USAID/SEAD. Në këtë drejtim, raporti i Grupit Punues fokusohet vetëm në veprimet e kërkuara nga akterët specifikë gjyqësorë për implementimin e asaj initiative, dhe që përndryshe rekomandon që plani i veprimit BRI të inkorporohet përmes referimit si një komponentë shtesë i Strategjisë Shtetërore për Zvogëlimin e Lëndëve të Vjetra të Grumbulluara.

Nën-grupet tematike të Grupit Punues: anëtarët dhe takimet		
Nën-grupi për lëmin penal	Nën-grupi për lëmin civil	Nën-grupi për përmbartimet
Fejzullah Hasani (Kryetar i Gjykatës Supreme) Salih Mekaj (Kryetar, GjQ Pejë) Zyheri Haziri (Kryetar, GjQ Gjiçan)	Ymer Hoxha (Kryetar, GjQ Prizren) Makifete Saliuka (U.D.Kryetare, GjK Prishtinë) Ragip Kadriu (Gjyqtar, GjK Mitrovicë)	Enver Peci (Gjyqtar, Gjykata Supreme/Kryesues, KGJK) Isa Shala (Kryetar, GjK Skenderaj) Murat Paçarada (Gjyqtar, Gj. Kundërvajtje, Prishtinë)
Takimet janë zhvilluar më 1, 18, 19, dhe 26 tetor 2010	Takimet janë zhvilluar më 28 shtator dhe 14, 15, dhe 20 tetor 2010	Takimet janë zhvilluar më 27 shtator dhe 15 tetor 2010

Strategjia është paraqitur si një pako veprimesh për entitetet në vijim:

1. Departamentin Ligjor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. Këshillin Gjyqësor të Kosovës
3. Sekretariati i Këshillit gjyqësor të Kosovës – Departamenti i Personelit, Departamenti i TI-së, Departamenti i Logjistikës, dhe Departamenti i Statistikës.
4. Gjykata – përfshirë edhe një pako të veçantë veprimesh që përkojnë me Iniciativën e mëparshme të USAID/SEAD mbi për Zvogëlimin e Lëndëve të Vjetra të Grumbulluara dhe të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës
5. Gjykatën Supreme
6. Përgjegjësitë trajnuese
7. Veprimet të tjera të ndryshme

**Vërejtje:** Memorandumet e propozuara të Mirëkuptimit duhet të hartohen pas shqyrtimit të kuadrit ligjor dhe rregullator për t'u siguruar se janë ende të nevojshme. Është i domosdoshëm verifikimi i rregullt që një ligj ose rregullore nuk e ka bërë të panevojshëm MeM. E njëjta gjë vlen edhe për dhënien e opinionëve juridike nga Gjykata Supreme.

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

**DEPARTAMENTI LIGJOR I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
1. Përpilimi i një formulari për – padinë (neni 99.2 LPK)	Në të ardhmen, mund të ndihmojë të hartimi i një formulari apo liste që përmban gjitha kriteret për të dhënat që duhet t’i përmbajë padia e kompletuar, ku me pas kjo liste t’ju lihet në dispozicion palëve.	1 muaj			Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. a. MiM ndërmjet KGJK-së, policisë, dhe postës në lidhje me dorëzimin e ftesave	Përveç nënshkrimit të memorandumit duhet të ketë edhe trajnime për anëtarët e policisë, postës dhe dorëzuesit e gjykatave mbi rëndësinë e dorëzimit dhe obligimet që parasheh MiM.	Hartimi: 3 muaj			Hartimi: Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. a.. Të bëhet një MiM ndërmjet KGJK dhe Policisë për lëndët e ekzekutimit penal	Me qëllim që të evitohet parashkrimi absolut duhet një bashkëpunim më i intensifikuar ndërmjet gjykatës dhe policisë.	Hartimi: 3 muaj			Hartimi: Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. a. Hartimi i MiM-it në mes të KGJK-së dhe Policisë së Kosovës për lëndët civile dhe lëndët përmbarrimore	MiM do të rregullojë bashkëpunimin në mes të palëve për ndihmë më efikas dhe më shpejt të policisë p.sh. asistencë në teren, vërtetimi i adresës etj.	3 muaj			Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. b. Hartimi i MiM-it në mes të KGJK-së dhe zyrës së regjistrimit civil	MiM do të rregullojë qasje drejtpërdrejtë në regjistrin civil nga ana e gjykatës.	3 muaj			Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
2. c. Hartimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe PTK-së	MiM do të rregullojë bashkëpunimin lidhur me dorëzimin e shkresave të gjykatës nëpërmes Postes. Ky memorandum do t'i i ndihmojë gjykatës që për rastet kur nevojitet që shkresat të ekspedohen nëpërmes postes të arrijnë me kohë dhe në përputhje me ligjin mbi dorëzimin dhe pranimin e shkresave.	3 muaj			Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. d. Hartimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe Agjencionin Kadastral të Kosovës	MiM do të rregullojë bashkëpunimin në mes të palëve për ndihmë në vërtetimin apo edhe marrjen e provave, shenjen e ekspertizave sipas kërkesës së gjykatës.	3 muaj			Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. e. Hartimi dhe nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe zyrës për regjistrimin e bizneseve	MiM do të rregullojë bashkëpunimin në mes të palëve në rast të çregjistrimit të bizneseve ose kërkesat për informatë lidhur me biznes që është debitor në procedurën përmbarimore.	Hartimi: 3 muaj			Hartimi: Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. f. Hartimi dhe nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe Bankës Qendrore	MiM do të rregullojë bashkëpunimin lidhur me identifikimin dhe bllokimin e xhirollogaritë bankare, caktimin e gjobave dhe sanksioneve të tjera për mos zbatimin e urdhëresave të gjykatës ose mos bashkëpunimin, procedimin e lëndëve të parashtruara nga bankat, etj.	Hartimi: 3 muaj			Hartimi: Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
3. Udhëzimi i KGjK-së që do të udhëzonte gjykatat mbi zbatimin plotë të ligjit sa i përket lirimin nga taksat gjyqësore, shpenzimet dhe paushallët në rastet penale, civile dhe të ekzekutimeve	Caktimi i paushallit dhe shpenzimeve gjyqësore në lëndë penale kur gjykatësi ka vlerësuar se i akuzuari është i varfër krijon lëndët përmbareme që koston shumë në burimet njerëzore dhe financiare mirëpo nuk ofrojnë mundësi për kryerjen e suksesshme të përmbaremit.	3-6 muaj			Hartimi: Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
4. a. Kthimi i lëndëve në rigjykim	Të propozohet amandamenti i ligjit përmes së cilit do të evitohet mundësia e prishjes së lëndës nga gjykata e shkallës së dytë më tepër se një herë.	Brenda vitit të parë të këtij plani			Hartimi: Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në koordinim me Gjykatat e instancës ankimore  Miratimi përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Kosovës
4. b. Heqja nga kompetenca e gjykatave të qarkut disa kategori të lëndëve (armëmbajtja pa leje)	Armëmbajtja pa leje si dhe rastet kur armëmbajtja pa leje gjykohet bashkë me një lëndë penale të lehtë (si p.sh nëse pas një vjedhjeje, bastiset shtëpia e te dyshuarit, dhe gjatë bastisje gjendet arma atëherë ai do si gjykatë kompetente do të caktohet gjykata e qarkut dhe ku do të gjykohej edhe për vjedhje edhe për armë mbajtje pa leje).	Brenda vitit të parë të këtij plani			Hartimi: Departamenti Ligjor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës  Miratimi përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Kosovës
4. c. Amendamenti i Ligjit mbi Sanksioneve Penale për të autorizuar konvertimin automatike i gjobave në dënim me burg kur nuk paguhet brenda afatit		Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani			Hartimi: Departamenti Ligjor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës  Miratimi përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

Veprim	Shpjegime	Afat shkurtër (0-12 muaj)	Afat mesatar (1-2 vite)	Afat gjatë (2- 3 vite)	Përgjegjës
5. Të shikohen mundësitë e punësimit të gjyqtarëve plotësues me mandat të kufizuar	Të shikohet mundësia e punësimit të ish-gjyqtarëve apo individëve të tjerë që i plotësojnë kushtet për tu emëruar gjyqtar që të punohen me mandat të kufizuar kohor - si një lloj task force.	1 vit			Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor i Kosovës do të përgatit një analizë e mundësive 1) brenda kornizës ligjore ekzistuese, apo 2) me amendamentimin e ligjeve.
6. Miratimi i rregullores së re sa i përket përgjegjësisë për mos efikasitet nga ana e gjyqtarit	Pasi të bëhet caktimi i normës për gjyqtarët, duhet që të nxjerrët një rregullore që përcakton se në rast se gjyqtarët nuk kryejnë normën, ka shkallë të lartë të kthimit nga gjykata apo ka zvarritje në procedimin e lëndëve të ndërmerren masa administrative. (Në rast të zvarritjes në procedim mund që kjo të monitorohet përmes një tablele që tregon kohën prej veprimit të fundit deri të veprimi tjetër, p.sh. të matet koha prej datës kur është mbajtur seanca përfundimtare deri ku është bërë përpilimi i aktgjykimit).	1 vit			Hartimi nga Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe miratimi nga Këshilli.  Pas miratimit, kryetarët duhet të monitorojnë zbatimin në gjykatat e tyre çdo 6 muaj.



**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
1. Udhëzimi i KGJK-së që do të udhëzonte gjykatat mbi zbatimin plotë të ligjit sa i përket lirimin nga taksat gjyqësore, shpenzimet dhe paushallët në rastet penale, civile dhe të ekzekutimeve	Caktimi i paushallit dhe shpenzimeve gjyqësore në lëndë penale kur gjykatësi ka vlerësuar se i akuzuari është i varfër krijon lëndët përmbareme që koston shumë në burimet njerëzore dhe financiare mirëpo nuk ofrojnë mundësi për kryerjen e suksesshme të përmbaremit.	3-6 muaj			Këshilli Gjyqësor i Kosovës
2. Caktimi i normave individuale të detyrueshme për gjyqtarët	Me qëllim që të mundësohet kontrolli i sasisë dhe eventualisht cilësisë së punës (të propozojnë secila grupe normat orientuese)	3-6 muaj			Këshilli Gjyqësor i Kosovës të caktojë një grup ekspertesh (gjyqtarët me përvojë) që do të punonin në caktimin e normave për gjyqtarë. Puna të ndahet në dy grupe: penale dhe civile.
3. a. Miratimi i rregullores së re sa i përket përgjegjësisë për mos efikasitet nga ana e gjyqtarit	Pasi të bëhet caktimi i normës për gjyqtarët, duhet që të nxjerrët një rregullore që përcakton se në rast se gjyqtarët nuk kryejnë normën, ka shkallë të lartë të kthimit nga gjykata apo ka zvarritje në procedimin e lëndëve të ndërmerren masa administrative. (Në rast të zvarritjes në procedim mund që kjo të monitorohet përmes një table që tregon kohën prej veprimit të fundit deri të veprimi tjetër, p.sh. të matet koha prej datës kur është mbajtur seanca përfundimtare deri ku është bërë përpilimi i aktgjykimit).	1 vit			Hartimi nga Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe miratimi nga Këshilli.  Pas miratimit, kryetarët duhet të monitorojnë zbatimin në gjykatat e tyre çdo 6 muaj.



**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
<p>3. b. Miratimi i rregullores për masat stimuluese për çdo lëndë të vjetër që kryhet (nëse është mbi norme)</p> <p>Vërejtje: Masa stimuluese të aplikohen jo vetëm për lëndë të vjetra, por edhe për lëndë të tjera nëse norma tejkalohet mbi 10%.</p>	<p>- Çmimi fiks (si në Mal të Zi), apo</p> <p>- Të kategorizohet me përqindje në raport me normë.</p>	1 vit			<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës cakton masat (p.sh 10EUR për gjykatat komunale, derisa 20 deri në 30 EUR për gjykatat e qarkut).</p> <p>Vlerësimi i masave stimuluese do të bëhet duke përjashtuar lëndëve të kryera sipas urdhrave ndëshkimor, parashkrimit absolut dhe relativ si dhe kryerjen e lëndëve për veprën të lehta penale si armëmbajtjen pa leje.</p>
3. b. Caktimi i skemës së masave stimuluese	Në rast se miratohen masat stimuluese duhet që të krijohet një grup punues i cili do të krijonte një sistem të caktimit të masave stimuluese dhe që do të mundësonte monitorimin dhe realizimin e tyre.	1 vit			Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<p>4. Ndërmjetësimi në lëndët gjyqësore</p> <p>Vërejtje: KGJK ka miratuar projektet pilot në bazë të propozimit të projektit SEAD të USAID-it.</p>	Riaktivizimi në Gjilan dhe Pejë të pilot projektit për ndërmjetësim, i zhvilluar në Gjykatën Komunale të Gjilanit. Implementimi i politikave të miratuara nga KGJK-ja për fillimin e projektit në fjalë. Përzgjedhja e lëndëve sipas kontesteve për ndërmjetësim mes palëve ndërgjyqësore.	6 muaj			Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Departamenti Ligjor i tij

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
5. Ndarja e lëndëve të bëhet në mënyrë objektive sipas rregullave strikte të paracaktuara me ndonjë akt të brendshëm të KGJK-së.	Të përcaktohet me Rregulloren e re të Brendshme mënyra e ndarjes së lëndëve në mënyrë që të bëhet standardizimi i ndarjes së lëndëve në të gjitha gjykatat duke marr parasysh edhe llojin dhe kompleksitetin (numri i të akuzuarve) e lëndëve. (Kjo duhet të bëhet nga Komisioni i Këshillit për Administrimin e Gjykatave)	6 muaj			Këshilli Gjyqësor i Kosovës
6. Numër unik për një lëndë	Një lëndë duhet të ketë një të vetmin numër pavarësisht se në cilën fazë gjendet. P.sh Penalet do të shifrohen me 'P', derisa faza me një shifër apo numër shtese si 'K' për Konfirmim Aktakuze apo diçka ngjashëm. Duhet të kryhet në kontekst të planifikimit për zbatimin e Ligjit mbi gjykatat. Mundësisht, edhe pas kthimit në rigjykim, lënda të mbaj prapë të njëjtin numër.	6 muaj	Zbatimi i plotë brenda 2 viteve		Këshilli Gjyqësor i Kosovës
7. a. MiM ndërmjet KGJK-së, policisë, dhe postës në lidhje me dorëzimin e ftesave	Përveç nënshkrimit të memorandumit duhet të ketë edhe trajnime për anëtarët e policisë, postës dhe dorëzuesit e gjykatave mbi rëndësinë e dorëzimit dhe obligimet që parasheh MiM.	Nënshkrimi: brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Nënshkrimi: Këshilli Gjyqësor të Kosovës
7. a. Të bëhet një MiM ndërmjet KGJK dhe Policisë për lëndët e ekzekutimit penal	Me qëllim që të evitohet parashkrimi absolut duhet një bashkëpunim më i intensifikuar ndërmjet gjykatës dhe policisë.	Nënshkrimi: brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Nënshkrimi: Këshilli Gjyqësor të Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
7. a. Nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe Policisë së Kosovës për lëndët civile dhe lëndët përmbare	MiM do të rregullojë bashkëpunimin në mes të palëve për ndihmë më efikas dhe më shpejt të policisë p.sh. asistencë në teren, vërtetimi i adresës etj.	3 muaj			Këshilli Gjyqësor të Kosovës
7. b. Nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe zyrës së regjistrimit civil	MiM do të rregullojë qasje drejtpërdrejtë në regjistrin civil nga ana e gjykatës.	3 muaj			Këshilli Gjyqësor të Kosovës
7. c. Nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe PTK-së	MiM do të rregullojë bashkëpunimin lidhur me dorëzimin e shkresave të gjykatës nëpërmes Postes. Ky memorandum do t'i i ndihmojë gjykatës që për rastet kur nevojitet që shkresat të ekspedohen nëpërmes postes të arrijnë me kohë dhe në përputhje me ligjin mbi dorëzimin dhe pranimin e shkresave.	3 muaj			Këshilli Gjyqësor të Kosovës
7. d. Nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe Agjencionin Kadastral të Kosovës	MiM do të rregullojë bashkëpunimin në mes të palëve për ndihmë në vërtetimin apo edhe marrjen e provave, shenjen e ekspertizave sipas kërkesës së gjykatës.	3 muaj			Këshilli Gjyqësor të Kosovës
7. e. Hartimi dhe nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe zyrës për regjistrimin e bizneseve	MiM do të rregullojë bashkëpunimin në mes të palëve në rast të çregjistrimit të bizneseve ose kërkesat për informatë lidhur me biznes që është debitor në procedurën përmbare.	Nënshkrimi: brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Nënshkrimi: Këshilli Gjyqësor të Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
7. f. Hartimi dhe nënshkrimi i MiM-it në mes të KGjK-së dhe Bankës Qendrore	MiM do të rregullojë bashkëpunimin lidhur me identifikimin dhe bllokimin e xhirollogaritë bankare, caktimin e gjobave dhe sanksioneve të tjera për mos zbatimin e urdhëresave të gjykatës ose mos bashkëpunimin, procedimin e lëndëve të parashtruara nga bankat, etj.	Nënshkrimi: brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Nënshkrimi: Këshilli Gjyqësor të Kosovës
8. Mos përdorimi i SMIL-it	Po ashtu duhet edhe të parashihen masa sanksionuese për ata persona që nuk e përdorin SMIL-in.	12 muaj			Këshilli Gjyqësor i Kosovës
9. Plani për sistemimin e gjyqtarëve plotësues	Nëse miratohet plani për gjyqtar plotësues, atëherë duhet që t'i paraprihet me një plan të detajizuar do të mundësonte raportimin/funksionalizmin, pra i cili do të identifikonte ato gjykata ku do të bëhet sistemi i këtyre gjyqtarëve.		1-2 vite		Afati dhe përgjegjësi varet nga analiza e bërë sipas veprimit 5 të Departamentit Ligjor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
10. Vendimi lidhur me organizimin e sistemit për përmbarim në të ardhmen (gjyqësor, publik, privat, etj.)	KGjK duhet të vendos për sistemin e përmbarimit më i përshtatshëm për Kosovën.		Brenda 2 viteve		Këshilli Gjyqësor i Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

**SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
<b><i>Departamenti i Personelit</i></b>					
1. a. Rekrutimi i stafit mbështetës: Bashkëpunëtoreve profesional	Rekrutimi i një numri të caktuar prej 3 ose 4 të bashkëpunëtoreve profesional si asistence për degën civile do të ndihmonte Kryetarin e degës dhe gjykatësit në përgatitjen e lëndëve për procedim më të shpejtë. P.sh.: Ndihma dhe asistenca e tyre do të fokusohet më shumë në hartimi n dhe përgatitjen e njoftimeve dhe urdhëresave gjyqësore.	3 muaj			Sekretariati i KGJK-së në koordinim me kryetarin e gjykatës.
1. a. Ngritët numri i bashkëpunëtorëve profesional	Kjo kategori punëtorësh do të ndihmonte gjyqtarët duke kryer punë profesionale dhe teknike (hartimi i vendimeve, urdhëresave dhe akteve të ndryshme, pa të drejtë në vendimmarrje. Raporti: dy gjyqtar, një bashkëpunëtor profesional		Të arrit në raportin 2 gjyqtar/1 bashkëpunëtor deri në fund të vitit të dytë të zbatimit të këtij plani.		Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Departamenti i Personelit)
1.b. Rekrutimi i stafit mbështetës: plotësimi e vendeve vakante ne administratën e gjykatës		3 muaj			Sekretariati i KGJK-së në koordinim me kryetarin e gjykatës.
<b><i>Departamenti i TI-së</i></b>					

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
1. Baza e të dhënave për personat kundër të cilëve zhvillohet procedurë penale në tërë territorin e Kosovës.	Ka rast kur për shkak të mbajtjes manual të të dhënave i njëjti person ka disa procedura në gjykatë që zhvillohen nga gjykatës të ndryshëm, dhe kjo data bazë do të evitonte një situatë të tillë dhje do të mundësonte bashkimin e lëndëve automatikisht.	Përpilimi i bazës së të dhënave: 3 muaj  Regjistrimi i të dhënave: brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani			Përpilimi: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Departamenti i TI-së)  Regjistrimi: Gjykatat
2. Përkrahje e plotë nga zyrtarët e TI-së	Në mënyrë që përdorimi i SMIL-it të ketë sukses nevojitet edhe një mbështetje më e intensifikuar përmes zyrtarëve shtesë të TI-së	6-12 muaj			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Departamenti i TI-së)
<b><i>Departamenti i Logjistikës</i></b>					
1. Caktimi i një veture të gjykatës për ekzekutim	Nëse gjykata ka më shumë se një veturë atëherë një duhet të caktojë për ekzekutimin në teren. Nëse gjykata ka vetëm një veturë atëherë do të ketë prioritet për veturën e re.	Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. a. Furnizimi i të gjithë gjyqtarëve me kompjuter (jo vetëm procesmbajtëset)		6 muaj			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. b. Caktimi i një deri në tri kompjuter/laptop për gjyqtarët civile	Gjyqtaret për daljen në vendshiqim kanë nevojë për kompjuter dhe printer për përpilimin e procesverbalit si dhe të vendimeve gjatë kohës sa gjinden në vendshiqim, etj.	3 muaj			Sekretariati i KGJK-së
2. c. Caktimi i një deri në tri kompjuter/laptop për zyrën e ekzekutimit	Referentët për ekzekutim kanë nevojë për kompjuter për përpilimin e inventarit të lëndëve, procesverbaleve, konkluzioneve, etj.	6 muaj			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
3. Identifikimi i lokali për mbajtjen e sendeve të luajtshme të konfiskuara në nivel komunal, të qarkut ose qendror	Mund të lëshohet me qira nëse mundësi tjetër nuk ekziston. Kjo duhet të vendos KGjK.	3 muaj			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
4. Furnizimi i gjykatave komunale me aparat fotokopjues sipas nevojave.	Kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve në lidhje me lëndët civile që kanë të bëjnë me autoritetet publike.	3 muaj			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
<b><i>Departamenti i Statistikës</i></b>					
1. Lëndët që kanë të bëjnë me shpenzimet procedurale, që kanë të bëjnë me buxhetin	Të mos evidentohen në raport si lëndë lëndët që kanë të bëjnë me buxhetin.	6 muaj			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Departamenti i Statistikës)



**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

**GJYKATAT**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
<b>Zgjidhje e menjëhershme</b>					
1. a. Masat alternative në lëndët penale	Të shfrytëzohen mundësitë që ofron legjislati sa i përket praktikumit të institucionit të ndërmjetësimit (neni 228 i KPP); marrëveshjes mbi fajësinë, urdhri ndëshkimor, etj.	1 muaj			Urdhri i Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë së Shtetit për të gjitha kryetarët dhe kryeprokurorët
1. b. Shfrytëzimi më i shpeshtë i masave alternative nga prokurorët	Prokurorët duhet që t'i shfrytëzojnë mundësitë që i parasheh ligji për zbatimin e masave alternative në ato rast kur ka mundësi që të përdoren sa më shpesh që është e mundur.	1 muaj			Urdhri i Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë së Shtetit për të gjitha kryetarët dhe kryeprokurorët
1. c. Përkrahja e shfrytëzimit të masave alternative nga gjyqtarët	Gjyqtarët, në bashkëpunim me palët duhet që të punojnë më shumë dhe të përkrahin shfrytëzimin e masave alternative.	1 muaj			Urdhri i Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë së Shtetit për të gjitha kryetarët dhe kryeprokurorët
2. Përpilimi i njoftimit për lëndët që kanë të bëjnë me autoritetin publik të Kosovës (ligji mbi menaxhimin e financave publike) dhe pezullimin tyre për 180 dite	T'i bashkëngjiten njoftimit kopja e padive dhe gjitha provat në dy kopje për 1) Ministrinë e Drejtësisë, 2) Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.				Kryetari i degës apo ndonjë gjykatës i cili caktohet do të hartojë njoftimin dhe me bashkëpunëtorin dhe administratën do të ekspedojë njoftimet.
3. a. Përpilimi i urdhërësës gjyqësore për palët në mënyrë individuale në rastet e padive të pa-kompletuara (me të meta) sipas nenit 102 të LPK-së.	Nxjerrja e urdhërësës gjyqësore për korrigjimin apo plotësimin e padive sipas afateve ligjore për rregullimin apo evitimin e të metave të padisë. P.sh. si në rastet kur mungon nënshkrimin e paditësit ose pagesën e taksës, në rastet e vdekjes së paditësit, në rastet e mungesës së provave.	3 -6 muaj			Gjykatësit dhe shefi i shkrimore

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
3. b. Marrjen e veprimeve sipas nenit 102 të LPK-së kur palët nuk përgjigjen në pajtim me urdhëresës.	P.sh. në rastet kur afatin prej 3 ditëve nuk korrigjohet apo nuk përgjigjet pala, padia do të konsiderohet si e tërhequr respektivisht do t'i hedhet poshtë.	6 muaj			Gjykatësit dhe bashkëpunëtorët profesional
4. a. Nxjerrja e vendimeve kur ekzekutimi e sanksioneve penale (sidomos gjobat) është parashkruar.	Pastrimi i lëndëve të parashkruara duhet të bëhet brenda një muaji. Pastaj duhet të rivlerësohet situata periodikisht.	1 muaj			Një gjyqtar i caktuar nga kryetari i gjykatës
4. b. Të merren vendimet te secila lëndë e cila është vjetërsuar, pra që ka kaluar afatin e parashkrimit.	Me qëllim që të hiqen nga statistikat si lëndë të pakryera, duhet që gjykata të marrin vendim për ato lëndë që realisht janë parashkruara por ende evidentohen si të pazgjidhura. Të konstatohen shkaqet e parashkrimit (a është parashkrimi absolut, apo relativ) dhe të identifikohen përgjegjësit.	3-6 muaj			Administratori evidenton dhe Kryetari, me Kolegjum udhëzon marrjen e vendimit.
<b>Lëndët Penale</b>					
1. Hartimi i një plani në secilin gjykatë përmes së cilës do të përcaktohej:	Inventarizimi duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e lëndës: numri i lëndës, lloji i lëndës, vlera, palët, etj.	Të fillojë menjëherë dhe të përfundojë brenda 1 muajit në gjykatat që kanë një inventar ekzistues, 3 muajve në gjykatat e vogla dhe 6 muajve në gjykatat e mëdha.			Vendoset nga Kolegjumi  Zbatohet nga Kryetari dhe Administratori
1. a. Përkufizimi i lëndëve të vjetra (p.sh lëndët deri me 31 12 2008).	Të gj. e qarkut ≤31.12.2008 Të gj. komunale duhet të merret parasysh afati për parashkrim relativ.	2 jave			Administratori

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
1. b. Inventarizimi i lëndëve.		Të fillojë menjëherë dhe të përfundojë brenda 2 muajve në gjykatat e vogla dhe 6 muajve në gjykatat e mëdha.			Administratori
1. c. Ndarja e atyre lëndëve të gjyqtarët.	Pas inventarizimit duhet të bëhet shpërndarja e lëndëve të vjetra sipas planit të gjykatës. Ndarja e lëndëve duhet të bëhet na bazë të proporcionalitetit.	Brenda 2 javëve të kryerjes së inventarizimit			Kryetari dhe Kolegjiumi (të bëhet ndarja varësisht prej numrit dhe kompleksiteti të lëndës; duhet të merren parasysh lëndët që kanë të bëjnë me nenet 146 dhe 147 të KP dhe lëndët me korrupsion dhe krimi i organizuar)
2. Të bëhet regjistrimi i të gjithave lëndëve penale – kundërvajtjes si dhe ekzekutimeve para viti 2008.	Në regjistrim të shënohen data e kryerjes së veprës, seanca e fundit të mbajtur si dhe koha e ardhjes së parashkrimit. Nga kjo kuptohet se sa lënde janë parashkruar dhe janë afër parashkrimit. (Kjo vjen në shprehje për gjykatën komunale dhe kundërvajtjes).	Të njëjtën afat sikurse në pikën 1. b.			Gjykatat

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
3. Të bëhet regjistrimi i lëndëve të cilët është lëshuar urdhër reshtim – fletëreshtim ndërkombëtar dhe vendor dhe sipas dispozitave automatikisht pas këtyre veprimeve caktohet paraburgimi.	Në momentin e regjistrimit të këtyre lëndëve të llogariten si në pritje administrative pasi gjykatësi nuk e ka çka të veprojë me tutje derisa të arrestohet i deshuari dhe momentin e arrestimit të fillohet procedura penale. P.sh. në gjykatën e qarkut ka lëndë që është kryer vepra penale në vitin 2000 dhe pas një kohe i deshuari ka ikur jashtë vendit, është lëshuar letereshtim ndërkombëtar, është caktuar paraburgimi dhe që dhjet vite lëndë është e pa kryer duke qëndruar te gjyqtari. Kësaj natyre të lëndëve ka ne gjykatat e qarkut por edhe në gjykatat komunale.	Të njëjtën afat sikurse në pikën 1. b.			Gjykatat
4. Dërgimi i lëndëve nga gjykata e shkallës së parë - Kalimi i afatit për mjet juridik	Lëndët mos të përcillen në gjykatë të shkallës së dytë apo të tretë pa kaluar afati i mjetit juridik për të gjithë të bashkë-akuzuarit.	1 muaj			Gjyqtarët nën mbikëqyrjen e Kryetarit
<b>Lëndët Civile</b>					
1. Emërimi i kryetarëve të degëve civile	Kryetarët e degëve civile do të jenë përgjegjës në implementimin dhe monitorimin e planit për reduktimin e lëndëve.	3 muaj			Emërimin e kryetarëve të degëve e bën kryetari i gjykatës në koordinim me kolegjiunin e gjykatës
2. Inventarizimi i lëndëve civile në mënyrë elektronike	Inventari duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e lëndës: numri i lëndës, lloji i lëndës (baza juridike), vlera, palët, etj.	2-3 muaj  Mirëmbajtja dhe azhurnimi i regjistrimit të inventarit bëhet rregullisht.			Stafi i administratës, respektivisht referenti i lëmisë civile me procesmbajtëse.

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
3. a. Kategorizimi i lëndëve	Kategorizimi bëhet sipas vjetërsisë së lëndës, sipas llojit të lëndës (bazës juridike), sipas statusit të paditësit ose të paditurve. P.sh.: në kontestet për kompensim demi të paditur janë UNMIK-u, KFOR-i dhe Komuna; apo në kontestet e kompensimeve të demit nga kompanitë e sigurimit. P.sh.: kontestet nga procedura përmbartimore pas kundërshtimit, ku në të shumtën e rasteve paditës është njëjtë subjekt juridik (PTK, KEK, Ujësjellësi, etj.).	3 muaj			Stafi i administratës, respektivisht shefi i shkrimores me referenti në lëminë civile dhe procesmbajtësit. Gjykatësit do të udhëheqin me procesin e kategorizimit.
3. b. Klasifikimi dhe grupimi sipas statusit në të cilën gjendet lënda	Statusi i lëndës mund të jetë: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndërprerje/pushim</li> <li>▪ Kompetenca lëndore/territoriale</li> <li>▪ Ndihmë juridike nga jashtë Kosovës</li> </ul>	3 muaj			Bashkëpunëtorët profesional, shefi i shkrimores dhe procesmbajtësit.
3. c. Klasifikimi dhe grupimi sipas shkaqeve të vonesave	Shkaqet e vonesave mund të jenë: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Llojit të metave të padisë</li> <li>▪ Adresa e panjohur</li> <li>▪ I padituri i panjohur</li> <li>▪ Mungesa e ekspertizës</li> <li>▪ Dorëzimi i shkresave</li> </ul>	6 muaj			Gjykatësit, bashkëpunëtorët profesional dhe procesmbajtësit.
4. Ricaktimi i gjykatësve sipas prioriteteve	Prioritet janë lëndët të cilat gjinden në fazën përfundimtare, lëndët të cilat gjenden në fazën sipas statusit të cekur më lartë dhe duke pasuar me lëndët ku vonesat janë më pak të ndërlikuara.	3 muaj			Kryetari i degës civile me gjykatësit në lëminë civile.

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
5. a. Caktimi i afateve kohor për procedimin e lëndëve (sipas kategorive)	Caktimin e afateve e bën kryetari i degës civile në koordinim me gjykatësit. Afatet kohore nuk duhet të jenë tepër shkurt ose tepër gjatë. Afatet kohore duhet të jenë norma për vlerësimin e punës, kuptohet duke marr parasysh gjithmonë natyrën e lëndëve, llojin e veprimit.	3 muaj			Kryetari i degës civile dhe kolegji i gjykatësve
5. b. Caktimi i masave sanksionuese	Në rast se gjyqtarët nuk i respektojnë këto afat cilat janë masat sanksionuese eventuale që mund të ndërmerren ndaj tyre? Çfarë masa administrative do të mund t'i inkurajonin gjyqtarët që të respektojnë këto afate?	3 muaj			Masat për punë jo efektive apo jo produktivitet. Sanksionet, nga vërejtja deri të largimi nga puna për jo produktivitet. Masat stimuluese: ngritja e të ardhurave, mirënjohjet, avancimet
6. a. Caktimi i orarit të punës në teren	Ndarja e lëndëve të cilat nevojitet vendshiqim apo dalja në teren siç quhet ndryshe do të mundësojë gjykatën që të caktojë paraprakisht ekipet e nevojshme si dhe planifikimin e mjeteve të duhura për këtë qellim.	3 muaj			Secili gjykatës të përpilojë kalendarin e lëndëve për dalje në teren dhe me pas bashkëpunëtori me administratorin përgatitin ekipet për dalje në teren.
6. b. Aranzhimi i veturave të gjykatës për daljen në teren	Nëse gjykata ka më shumë se një veturë atëherë një duhet të caktojë në përputhje me orarin e grupit të lëndëve në të cilat duhet të bëhet vendshiqimi. Nëse gjykata ka vetëm një veturë atëherë do të ketë prioritet për veturën e re e cila do të mundësonte që gjykatat të mos përdorin makinat e palëve gjatë daljes në terren.	3 muaj			Sekretariati i KGJK-së për mundësinë e shtimit të numrit të veturave mobile të cilat do të përdoren vetëm për këtë qellim.

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
7. Bashkimi i padive dhe kundërpadive	Bashkimi i gjitha lëndëve të cilat i nënshtrohen kritereve për bashkimin e tyre (kjo mund të behët përmes inventarit të lëndëve)	6 muaj			Gjykatësi dhe bashkëpunëtori profesional
8. a. Rishikimi i statusit të lëndës dhe nxirrja e vendimeve ne përputhshmëri me statusin e lëndës.	Riaktivizimi i lëndëve të cilat gjenden në statusin e ndërprerjes apo pushimit, cedimin e lëndëve në kompetencë të Dhomës së Veçante të Gjykatës Supreme, si dhe rishikimin e statusit të kërkesave për ndihme juridike.	3 muaj			Gjykatësi me bashkëpunëtorin profesional
8. b. Caktimi i personit përgjegjës	Për rishikimi i statusit të lëndës dhe nxirrja e vendimeve në përputhshmëri me statusin e lëndës duhet që të caktohet një person i cili do të monitoronte këtë proces.	3 muaj			Për secilin grup të lëndëve, sipas klasifikimeve si në kolonën 3.1; 3.2; 3.3; 3.4 caktohen bashkëpunëtorët profesional të cilët do të koordinojnë punën për atë grup të lëndëve
<b><i>Lëndët e Ekzekutimeve</i></b>					
1. a. Caktimi i një grupi punues për zvogëlimin e lëndëve të vjetra të ekzekutimeve (penale/civile) në çdo gjykatë komunale dhe në gjykatën ekonomike.		2 javë			Kryetari i gjykatës
1. b. Trajnimi për grupin punues	Duhet të njoftojë grupin për detyrat dhe përgjegjësitë e tij si dhe për mënyrën e organizimit të punës.	Pas themelimit të grupit punues (java e tretë)			Kryetari dhe Administratori i Gjykatës
2. Identifikimi i stafit mbështetës që mund të ndihmojnë në ekzekutim si dhe lëshimi i urdhërësës së caktimit nga kryetari i gjykatës	Disa nga gjykatat të vogla kanë pasur sukses me ri-caktimi parcial e punëtorëve që janë më pak të ngarkuar me punë. P.sh. përkthyesit, arkivistët, edhe, në të ardhmen, referentët për legalizim.	2 javë			Kryetari i gjykatës në bashkëpunim me administratorin



**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
<p>3. Inventarizimi i lëndëve të ekzekutimeve civile dhe penale në mënyrë elektronike</p> <p>Vërejtje: Kategorizimi bëhet në koordinim me programin SEAD</p>	<p>Inventar duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e lëndës: numri i lëndës, lloji i lëndës, vlera, palët, etj.</p> <p>Para se të fillohet gjykata duhet të koordinojë me programin SEAD për të siguruar se të gjitha të dhënat e nevojshme për iniciativën e programit SEAD të detajizuar më poshtë janë përfshirë në inventar elektronik.</p>	<p>Duhet të fillojë brenda 2 javësh.</p> <p>Inventari i lëndëve të mëparshme duhet të kryet brenda 1 muajit në gjykatat e vogla dhe brenda 3 muajve në gjykatat e mëdha.</p> <p>Mirëmbajtja dhe azhurnimi i regjistrit behet në vazhdimësi.</p>			Grupi punues sipas detyrës së anëtarëve
4. Kategorizimi i lëndëve	Kategorizimi bëhet përmes inventarit sipas llojit të lëndës ose kreditorit. P.sh. në ekzekutim civil: KEK, PTK, bankat, shpenzimet procedurale, etj. P.sh. në ekzekutim penal: gjobat sipas vlerës.	Fillon menjëherë pas kryerjes së inventarit të lëndëve të një viti.			Grupi punues
5. a. Caktimi i afateve kohor për procedimin e lëndëve (sipas kategorive)	Caktimi bëhet grupit punues. Afatet kohore nuk duhet të jenë tepër shkurt ose tepër gjatë. Afatet kohore duhet të jenë norma për vlerësimin e punës.	Bëhet pas inventarizimit dhe kategorizimit të lëndëve. Caktimi duhet të behet brenda 3 muajve në gjykatat e vogla dhe brenda 6 muajve në gjykatat e mëdha.			Grupi punues

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
5. b. Caktimi i masave sanksionuese ose ndihmuese nga kryetari i gjykatës	Në rast se referentët nuk i respektojnë këto afat, kryetari duhet të autorizohet që të ndërmerr masat ndaj tyre. Çfarë masat disiplinore mund të ndërmerr? Çfarë masat administrative do të mund t'i zbatohen për të ndihmuar ose inkurajuar referentët që të respektojnë këto afate? Masat ndihmuese duhet të caktohet për shkak të pengesave objektive që mund të ndikojnë në zbatimin e planit.	Bëhet sipas afatit të caktuar për veprimin 8. a.  Zbatimi i masave behet në vazhdimësi.			Kryetari i grupit punues në bashkëpunim me Kryetarin dhe Administratorin e Gjykatës
6. Caktimi i orarit të punës në teren sipas lagjeve	Procedimi i lëndëve sipas vitit nuk ndalon procedimi i një lënde të vitit 2010 në njëjtën kohe si një lëndë të vitit 2003 nëse janë në njëjtën rrugë. Kjo do të inkurajojë menaxhimin më efikas të kohës.	Bëhet pas inventarizimit të lëndëve. Caktimi duhet të behet brenda 1 muajit në gjykatat e vogla dhe brenda 3 muajve në gjykatat e mëdha.			Grupi punues
7. Puna e vazhdueshme sipas kategorizimit dhe orarit të punës në teren me rishikimin çdo 6 muaj	Rishikimi do të sigurojë se objektivat e planit të grupit punues janë përmbushur.			Plani duhet të kryet brenda 3 viteve.	Kryetari i grupit punues në bashkëpunim me Kryetari dhe Administratori të Gjykatës.
<b><i>Iniciativa të veçanta për përmbarim: Iniciativa nga USAID SEAD për Zvogëlimin e Lëndëve të Vjetra të Grumbulluara e Miratuar nga Këshillit Gjyqësor i Kosovës</i></b>					
Menjëherë pas fillimit të iniciativës për Zvogëlimin e Lëndëve të vjetra të grumbulluara në një gjykatë, Kryetari i Gjykatës në bashkëpunim me administratorin dhe shefin e shkrimores duhet të sinkronizojnë ricaktimin e stafit në mbështetje të zvogëlimit të lëndëve të vjetra përmbarimore dhe të gjitha veprimtarive të zbatuara në përputhje me veprime e përfshira në bashkërendim me Ekipin e SEAD dhe Njësitë e Veçanta Përmbarimore nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.					
Përpos kësaj, veprimet që ndërlihen me përmbarimin civil nën pjesën “Ekzekutimi” të seksionit të gjykatave, duhet të bashkërendohet me Projektin e USAID/SEAD dhe KGJK-së për Zvogëlimin e Lëndëve të Vjetra të Grumbulluara ashtu që të sigurohet konsistenca në qasje dhe që efikasiteti të jetë maksimal.					

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
1. Caktimi i personit kontaktues të emëruar në secilën gjykatë Komunale që të bashkërendohet me Ekipin e SEAD dhe Njësinë e Veçantë Përmbartimore të KGJK-së (aty ku janë caktuar njësitë (NVP-të)		2 javë			Kryetari i Gjykatës
2. Inventarizimi elektronik dhe kategorizim të lëndëve përmbartimore	Përdorimi i bazës së të dhënave të zhvilluar nga SEAD dhe pas trajnimeve nga Menaxheri i të dhënave nga SEAD, Ekipi SEAD dhe praktikantët e KGJK do të inventarizojnë dhe kategorizojnë lëndët. Pas vendosjes së Njësisë së Veçantë Përmbartimore të KGJK-së, KGJK NjVP do të bëjë inventarizimin dhe kategorizimin e lëndëve. Kategorizimi kryhet sipas llojit të lëndës, kreditorit, statusit, vlerës dhe kritereve të tjera. Lëndët jo të plota apo të pa rregullt do të pezullohen dhe do t'i kthehen kreditorit për rishikim (KEK dhe PTK). Lëndët e përcaktueshme do të hudhen <i>ex officio</i> .	Inventarizimi dhe kategorizimi ka filluar më 15 tetor. Gjykata do të vizitohen nga Ekipet e KGJK dhe SEAD BRI sipas një orari rotativ siç miratohet nga KGJK.	Pasi të jetë përfunduar baza e të dhënave, mirëmbajtja e regjistrit është e vazhdueshme.		SEAD, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kryetarët e Gjykatave dhe Zyrtarët Përmbartimore.
3. Të vepohet sipas marrëveshjes së arritur me KEK dhe PRK për pezullimin/hudhjen e lëndëve.	Lidhur me lëndët e KEK dhe PTK, sipas marrëveshjes lëndët jo të plota apo të pa rregullt do të pezullohen dhe do t'i kthehen kreditorit për rishikim dhe lëndët e përcaktueshme do të hudhen <i>ex officio</i> .	Brenda vitit të parë të implementimit të këtij plani.			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Njësitë e Veçanta Përmbartimore) në bashkëpunim me zyrtarët përmbartimore të gjykatës.

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
4. “Procedime grupore” të lëndëve përbarimore bazuar në kategoritë dhe në vendndodhjen gjeografike.	Në përputhje me vendimin e bordit të KGJK-së që shpall rrethana të veçanta të cilat lejojnë të trajtohen jashtë renditjes kohore).	Brenda vitit të parë të implementimit të këtij plani.			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Njësitë e Veçanta Përbaruese) në bashkëpunim me zyrtarët përbarimorë të gjykatës.
5. Nga kryetari i gjykatës caktohet zhvillimi i stimulimeve pozitive dhe sanksioneve disiplinore apo i masave mbështetëse.	Janë zhvilluar stimulime për performancë superiore dhe kryetari i gjykatës është veshur me autoritetin për të ndërmarrë veprime për performancën që është nën standarde.				Kryetari i Gjykatës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

**GJYKATA SUPREME**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
1. Mbatja e seancave dëgjimore në shkallë të dytë	Të kërkon qëndrim juridik të Gjykatës Supreme që të shtohet detyrimi për hapjen e seancës para gjykatës së shkallës së dytë kur aktgjykimi duhet të priset për shkak të fakteve.	6 muaj			Gjykata Supreme
2. Qartësimi i detyrës së gjykatës në lëndët e ekzekutimit në rast të adresës së panjohur ose pa sakte.	Kërkon qëndrim juridik të gjykatës supreme: kur adresa e palës është e panjohur ose pa sakte, kur gjykata mund të pezullojë lëndë?	Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Gjykata Supreme
3. Qartësimi i autoritetit të gjykatës për sekuestrimin e kolateralit të tjetërsuar në lëndët e ekzekutimit civil	Me qëllim të unifikimit të praktikave të ndryshme nëpër gjykata sa i përket sekuestrimit të kolateralit të tjetërsuar, Gjykata Supreme të nxjerr një qëndrim juridik se si duhet të veprojë gjykata në këto raste.	Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Gjykata Supreme
4. Ekzekutimi i gjobave nga gjykatat e qarkut	Pasi që ka një laramani në ekzekutimin e gjobave nga niveli i gjykatave të qarkut, nevojitet një qëndrim juridik nga Gjykata Supreme në lidhje me këtë çështje: a janë gjykatat e qarkut kompetent për ekzekutimin e gjobave të cilat kanë lëshuar?	Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani			Gjykata supreme
5. Rrethana të posaçme për procedimin e rasteve të ekzekutimit civil	Të kërkojë nga Gjykata Supreme një opinion juridik për të deklaruar rrethanat e veçanta që do të lejojnë gjykatave që të procedojë rastet e ekzekutimeve civil jashtë radhës.	Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani			Gjykata supreme

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

**PËRGJEGJESITË PËR TRAJNIM**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Përgjegjës</b>
1. Trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit mbi SMIL	Të gjithë gjyqtarët dhe stafi përkrahës duhet që të trajnohen mbi përdorimin e SMIL-it dhe që ai të behët obligator në përdorim.	6 muaj			Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. a. Trajnimi orientues për përfaqësuesit e institucioneve me ke është nënshkruar MiM	Trajnime orientues do të sigurojnë se ata institucione janë njoftuar me detyrat dhe obligimet e caktuara në MiM.	Brenda 2 muajve pas nënshkrimit të secilit MiMi.			Këshilli Gjyqësor të Kosovës i cakton prezantuesit.
2. b. Qartësimi dhe trajnimi i stafit të dorëzuesve të gjykatës për procedurat e ekspeditimit të rregullt të shkresave (dorëzimi i drejtpërdrejt dhe dorëzimi reprezentativ) sipas neneve 110 dhe 111 të LPK-së.	Trajnimi i stafit të dorëzuesve të gjykatës për dorëzim të rregullt të shkresave paraqet një element vendimtar procedimin e shpejt dhe pa vonesa të lëndëve. Ngritja e njohurive të këtij stafi do të mund të zgjidhte shumë çështje të vonesave sikur në rastet e adresave të panjohura, shpërngulja e paditësve në adrese të panjohur apo edhe kur të paditurit ju shmangen pranimit të shkresës së gjykatës.	3 muaj			Sekretariati i KGJK-së në një trajnim te përgjithshëm. Ndërsa në gjykatë shefi i shkrimoreve dhe Kryetari i degës civile.
3. Trajnimi i vazhdueshëm mbi ligjet e reja për referentët përmbaues	Trajnime do të organizohet jo vetëm për gjyqtarët mirëpo edhe për referentët përmbaues dhe bashkëpunëtorët profesional. Çdo vit duhet të këtë 3 ose 4 trajnime mbi temat të ndryshme lidhur me ligjet e reja ose problematike praktike të caktuara sipas propozimeve të gjykatave.	I vazhdue-shëm	I vazhdue-shëm	I vazhdue-shëm	Instituti Gjyqësor i Kosovës

**PROPOZIM STRATEGJIA SHTETERORE PËR ZVOGËLIMIN E LËNDËVE TË VJETRA TË GRUMBULLUARA  
8 NËNTOR 2010**

**VEPRIME TJERA**

<b>Veprim</b>	<b>Shpjegime</b>	<b>Afat shkurtër (0-12 muaj)</b>	<b>Afat mesatar (1-2 vite)</b>	<b>Afat gjatë (2- 3 vite)</b>	<b>Ndërmarrësi i Veprimit</b>
1. Bartja e detyrës së identifikimit të adresës të lëndët përbarimore nga gjykata tek kreditori.	Mund të rregullohet me ligjin e ri për procedurën përbarimore të cila është në proces të hartimit.	Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani.			Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi
2. a. Kthimi i lëndëve në rigjykim	Të propozohet amandamentimi i ligjit përmes së cilit do të evitohet mundësia e prishjes së lëndës nga gjykata e shkallës së dytë më tepër se një herë.	Brenda vitit të parë të këtij plani			Miratimi përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Kosovës
2. b. Heqja nga kompetenca e gjykatave të qarkut disa kategori të lëndëve (armëmbajtja pa leje)	Armëmbajtja pa leje si dhe rastet kur armëmbajtja pa leje gjykohet bashkë me një lëndë penale të lehtë (si p.sh nëse pas një vjedhjeje, bastiset shtëpia e te dyshuarit, dhe gjatë bastisje gjendet arma atëherë ai do si gjykatë kompetente do të caktohet gjykata e qarkut dhe ku do të gjykohej edhe për vjedhje edhe për armë mbajtje pa leje).	Brenda vitit të parë të këtij plani			Miratimi përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Kosovës
2. c. Amendamenti i Ligjit mbi Sanksioneve Penale për të autorizuar konvertimin automatike i gjobave në dënim me burg kur nuk paguhet brenda afatit		Brenda vitit të parë të zbatimit të këtij plani			Miratimi përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Kosovës